



POZICION VAKANT – DREJTOR I DEGES FIER

DETYRAT E PERGJITHSHME:

- Siguron mbikëqyrje efektive të aktivitetit bankar të Degës, në përputhje të plotë me kuadrin legjislativ dhe rregullator, si edhe me politikat dhe procedurat e brendshme të Bankës.
- Drejton aktivitetin e Degës në mënyrë të tillë që të arrihen objektivat e biznesit të percaktuara sipas planit të biznesit të Alpha Bank Albania.
- Mbikëqyr dhe garanton shitjen në kohë dhe me cilësi të produkteve dhe shërbimeve të Bankës adresuar klientelës së synuar.
- Ka përgjegjësinë kryesore të arritjes së objektivave të përfitueshmërisë, zhvillimit në treg dhe cilësisë së portofoleve në linjë me planin e përgjithshëm të biznesit të Alpha Bank Albania.
- Planifikon, organizon dhe mbikëqyr në mënyrë direkte gjithë aktivitetin ditor të degës duke drejtuar, trajnuar dhe motivuar stafin në varësi, si edhe duke ndjekur në mënyrë korrekte zbatimin e rregullave dhe procedurave të Bankës.
- Bashkëpunon me Njësitë e Biznesit të Bankës për të shitur produkte të kombinuara tek tregu i synuar.
- Shfrytëzon mundësitë e tregut në zonën gjeografike ku operon në drejtim të menaxhimit të klientelës dhe zhvillimit të biznesit.
- Vendos, zhvillon dhe mirëmban raportet e biznesit me klientet ekzistues dhe ata të ardhshëm, duke pasur si qëllim rritjen e bazës së klientëve të degës, veçanërisht atyre individë dhe biznese të vogla, dhe promovon produktet e Bankës.

KUALIFIKIMET:

- Të zotëroje diplomë universitare në Ekonomi ose në fusha të ngjashme
- Të përdorë në mënyrë të shkëlqyer gjuhën shqipe dhe atë angleze
- Duhet të ketë të paktën pesë (5) vjet eksperiencë bankare
- Duhet të ketë të paktën tre (3) vjet eksperiencë drejtuese

AFTESITE:

- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe menaxhimi.
- Aftësi shumë të mira analitike dhe në të shkruar.
- Aftësi shumë të mira për të menaxhuar kohën e punës, prioritetet si dhe aftësi të forta organizative.
- Aftësi shumë të mira për të punuar në grup.
- Të zbatojë në mënyrë rigorozë politikat dhe procedurat e Bankës dhe të Grupit.
- Të karakterizohet nga dëshira për t'u rritur profesionalisht në vijimësi.

Kandidatët e interesuar mund të dërgojnë biografite të tyre profesionale në adresën e e-mail: hr.albania@alpha.gr

Të gjitha aplikimet do trajtohen me konfidencialitet maksimal. Vetëm kandidatët që përmbushin kriteret e vendosura më sipër do kontaktohen.